

BASHKIA TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

1. Drejtuar: Operatorit ekonomik “2 N”sh.p.k

Adresa: Rruga “Demokracia” , Pallati nr.2, Kati i Parë, Lagja Paskuqan Fushë, Paskuqan, Tiranë;

NIPT: L31615017L

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

2. Tipi i Kontratës: Punime ndërtimi

3. Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur”

4. Numri i Procedurës / referenca: **REF- 88205-06-01-2026**

5. Objekti i kontratës: “Ndërtimi i rrugës që lidh pronën nr.99 “Reparti Ushtarak nr.5011/45”, Surrel me Rrugën Nacionale”.

6. Fondi limit: **18,941,970** (tetëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzet e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

7. Burimi i financimit: *me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2026, miratuar me VKB Nr.35, datë 30.03.2026, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026”.*

8. Kohëzgjatja e kontratës: 4 (katër) muaj.

9. Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit:
21.07.2026

10. Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini **Nr. 47**, datë **27 Korrik 2026**.

11. KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “DEHA 2010” sh.p.k

NIPT: L03425410B

Vlera: 11,321,520.00 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e njëzet e një mijë e pesëqind e njëzet) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

2. Operatori ekonomik “KEGLI-DURI”

NIPT:K94016202U

Vlera: 11,597,412.00 (njëmbëdhjetë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

3. Operatori ekonomik “DRINI-1” sh.p.k

NIPT:J78716317H

Vlera: 12,307,032.25 (dymbëdhjetë milionë e treqind e shtatë mijë e tridhjetë e dy pikë njëzet e pesë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

4. Operatori ekonomik “EM-EA CONSTRUCTION” sh.p.k

NIPT:M56827701I

Vlera: 12,655,466.00 (dymbëdhjetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

5. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Colombo LTD” sh.p.k & “MELA.”sh.p.k

NIPT:M31420052T ; NIPT:K62320011G

Vlera: 13,186,276.30 (trembëdhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë tridhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

6. Operatori ekonomik “2 N” sh.p.k

NIPT:L31615017L

Vlera: 14,899,632,00 (katërmëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

7. Operatori ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” sh.p.k

NIPT:L78006801F

Vlera: 15,151,360.77 (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë pike shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

8. Operatori ekonomik “ISEC” sh.p.k

NIPT:L41309004L

Vlera: 16,114,177.08 (gjashtëmbëdhjetë milionë e njëqind e katërmëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë zero tetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

9. Operatori ekonomik “MARVELS”S Construction Group”sh.p.k

NIPT:J77506312B

Vlera: 18,745,100.00 (tetëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

* * *

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik “DEHA 2010” sh.p.k

Operatori ekonomik “DEHA 2010” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.10 gërma b, ku percaktohet se: *“Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik si dhe operatorët mbështetës të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetës duhet të deklarojnë për punonjësit e mesipër emrin/mbiemer, profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e deshmisë së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmerisë së saj”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “DEHA 2010” shpk nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit afatin e vlefshmerisë së deshmisë së aftësisë profesionale për punonjësit eskavatorist, automakinist, buldozerist dhe për pasojë nuk permbush kërkesën për punonjësit e kërkuar në nenin 2.3.10.

Operatori ekonomik “KEGLI-DURI” shpk

Operatori ekonomik “KEGLI-DURI” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.9 gërma b, ku percaktohet se: *“Për punonjësit e tjerë të stafit teknik duhet të deklarohet emër/mbiemer, profili i punës, numri i kontratave individuale të punës, numri dhe titulli i kualifikimit për dëshmi /certifikatë/diplomë përkatëse, si dhe institucioni që ka lëshuar dokumentin bazuar në Ligjin 15/2017”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “KEGLI-DURI” shpk nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit të dhënat si numri dhe institucionin që ka lëshuar dokumentin bazuar në Ligjin 15/2017 për punonjësin Betonues dhe për pasojë nuk permbush kërkesën për punonjësit e kërkuar në pikën 2.3.9, për 1 (një) punonjës betonues.

Operatori ekonomik “DRINI-1” shpk

Operatori ekonomik “DRINI-1” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, pika 1, ku percaktohet se: *“Ofertuesi duhet të paraqesë: Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “DRINI - 1” shpk nuk ka plotësuar në Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit tek “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” konkretisht për rubrikat 8 dhe 10 si më poshtë:

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate”.

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Gjithashtu, Operatori ekonomik “DRINI-1” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik pika 1 ku percaktohet se:

1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a.Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 9,470,985 (nëntë milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b.Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 37,883,940 (tridhjetë e shtatë milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën e kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Nga verifikimi i dokumenteve të dorëzuara nga operatori ekonomik “DRINI-1” shpk në sistemin e prokurimeve elektronik të rezultojnë se për përmbushjen e punës së ngjashme ka paraqitur kontrata ndër të cilat objektet e mëposhtme nuk konsiderohen punë e ngjashme me objektin e këtij prokurimi, Konkretisht kontrata si më poshtë:

1. Kontrata me objekt: “Ndërhyrje në tunelin e Gojanit, masat inxhinierike për mbrojtjen e skarpave” realizuar si bashkim operatorësh , në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tij në bashkim në masën 55 %, ose në vlerën 7,822,729.29 leke pa tvsh;

2. Kontrata me objekt: “Ndërtim kanalizime të Ujrave të ndotura "Zona ish-MCR, Rr.Gaqi Gjika Bashkia Berat” realizuar si bashkim operatorësh , në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tij në bashkim në masën 46 %, ose në vlerën 5,438,500.65 leke pa tvsh;

3.Kontrata me objekt: “Rikonstruksion i shkarkuesit katastrofik të rezervuarit Malaj, Bashkia Mirdite” realizuar si bashkim operatorësh , në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tij në bashkim në masën 55 %, ose në vlerën 4,326,444.83 leke pa tvsh;

Objektet e paraqitura si punë të ngjashme, “Ndërhyrje në tunelin e Gojanit, masat inxhinierike për mbrojtjen e skarpave”, “Ndërtim kanalizime të Ujrave të ndotura "Zona ish-MCR, Rr.Gaqi Gjika Bashkia Berat” dhe “Rikonstruksion i shkarkuesit katastrofik të rezervuarit Malaj, Bashkia Mirdite” nuk konsiderohen si punë të ngjashme me objektin e prokurimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, për kontratën me objekt: “LOTI V Mirembajtje rutine dhe Dimerore me performancë rruga "Rreshen (U.Fanit)- Shpal-Shpal-Q.Bene-K.Hadroj,Shpal-Ura e Repsit (58.7 km)”dhe “Riparim mirembajtje i rrugëve të brendshme të Spitalit”, rezultoi se operatori ekonomik “Colombo LTD” shpk nuk ka paraqitur akt kolaudimin për punët e paraqitura. Referuar pikës 2.3.1/1 germa b, të kapacitetit teknik në DST, citohet se: “Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Aktin e kolaudimit”...

Operatori ekonomik “DRINI - 1” shpk, nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.1 ku përcaktohet se: “Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:....”.

Vlera totale e kontratave të deklaruara dhe që janë punë të ngjashme është 7,745,628.8 lekë pa tvsh, ndërkohe vlera që nevojitet për t’u plotësuar nga operatori ekonomik “DRINI-1” shpk, në përmbushje të Kapacitetit Teknik 2.3 pika 1 germa a dhe b, vlera për një punë të ngjashme duhet të ishte 9,470,985 leke pa tvsh ose vlera totale e punëve të ngjashme të deklaruara, duhej të ishte në vlerën 37,883,940 leke pa tvsh.

Operatori ekonomik “EM-EA CONSTRUCTION” sh.p.k

Operatori ekonomik “EM-EA CONSTRUCTION” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.10 gërma a, ku percaktohet se: “Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik si dhe operatorët mbështetes te deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetes duhet të deklarojnë për punonjësit e mesipër emrin/mbiemër, profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmerise se saj.

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “EM-EA CONSTRUCTION” shpk nuk ka deklaruar ne Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit afatin e vlefshmerise së deshmise, së aftësisë profesionale për punonjësit eskavatorist, buldozeriste dhe për pasojë nuk permbush kërkesën për punonjësit e kërkuar në piken 2.3.10.

Operatori ekonomik “EM-EA CONSTRUCTION” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.8, ku percaktohet se: “Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tij personel të kualifikuar/certifikuar për 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.....”. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “EM-EA CONSTRUCTION” shpk nuk ka deklaruar ne Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit 1 (një) punonjes të pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” dhe për pasojë nuk permbush kërkesën për punonjësin e kërkuar në nënpgkën 2.3.8 të kapaciteti teknik pika 2.3 të DST.

Operatori ekonomik “EM-EA CONSTRUCTION” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.13, ku percaktohet se: “Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçense të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mjetëve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.....”. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “EM-EA CONSTRUCTION” shpk nuk ka paraqitur Liçensen e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mjetëve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit.(Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera bëhet bazuar në ligjin nr 162/2020 Për prokurimin Publik, I ndryshuar, neni 84 si dhe Vkm nr.285 datë 21.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 90)

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Colombo LTD” shpk & “MELA.” shpk

Operatori ekonomik “MELA.” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.14 gërma g , ku percaktohet se: “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit te cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi.”Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “MELA.” shpk i ka të angazhuara mjetet në kontratën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi i bllokut te tregu Çam” dhe për pasojë nuk permbush kërkesën mjetet që nevojiten në dispozicion për zbatimin e kontratës. Operatori ekonomik “Colombo LTD” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti

Teknik, pika 2.3.14 gërma f , ku percaktohet se: “Për mjetet që sipas percaktimeve ligjore te qarkullimit rrugor nevojitet targa, leje qarkullimi...etj. Operatori ekonomik duhet te deklaroje në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në rubriken përkatëse të dhënat për mjetet e kërkuara në Kapacitetin Teknik 2.3, nën-pika 2.3.14 “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion...” Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “Colombo LTD” shpk nuk ka deklaruar targat për mjetin Autobitumatrice në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në rubrikat përkatëse dhe për pasojë nuk përmbush kërkesën mjetet që nevojiten në dispozicion për zbatimin e kontratës konkretisht për mjetin Autobitumatrice copë 1.

Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Colombo LTD” shpk & “MELA.” shpk nuk përmbushin Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.13, ku percaktohet se: “Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçense të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.....”. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “MELA.” shpk ka paraqitur Liçensen e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Transport i mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet), së bashku me aktin e miratimit, e cila është license vetëm për transportin e mbetjeve dhe jo grumbullimin e tyre dhe për pasojë nuk përmbush kërkesën për disponimin e liçensën III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta)..

Operatori ekonomik “ISEC” sh.p.k

Operatori ekonomik “ISEC” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.14 gërma f , ku percaktohet se: “Për mjetet që sipas percaktimeve ligjore te qarkullimit rrugor nevojitet targa, leje qarkullimi...etj. Operatori ekonomik duhet te deklaroje në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në rubriken përkatëse të dhënat për mjetet e kërkuara në nën-pikën 2.3.14 të Kapacitetit Teknik 2.3. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “Colombo LTD” shpk nuk ka deklaruar të dhënat për mjetin Autobitumatrice në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në rubrikat përkatëse dhe për pasojë nuk përmbush kërkesën mjetet që nevojiten në dispozicion për zbatimin e kontratës.

Operatori ekonomik “ISEC” shpk nuk përmbushin Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.13, ku percaktohet se: “Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçense të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.....”. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “ISEC” shpk ka paraqitur Liçensen e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Transport i mbetjeve nga ndertimet dhe prishjet), së bashku me aktin e miratimit, e cila është license vetëm për transportin e mbetjeve dhe jo grumbullimin e tyre dhe për pasojë nuk përmbush kërkesën për disponimin e liçensën III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta).

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, operatorin Ekonomik **“2 N” shpk** me NIPT: **L31615017L**, adresë: **Tiranë, Rruga “Demokracia”, Pallati 2, Kati 1, Paskuqan** dhe ofertë të paraqitur me vlerë totale prej: **Vlera: 14,899,632,00** (katërmëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **15,151,360.77** (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë pike shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐

JO ☒